

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-256/13

Prishtinë,

12 Gusht 2015

Në çështjen juridike të:

B. V.

Serbi

Pala ankuese

Kundër

A. dhe K. K.

Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga gjyqtarët Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit, Elka Ermenkova dhe Rolandus Bruin, anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën ndaj vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/180/2012 (lëndët e regjistruara në AKP me numrat KPA22870, KPA22871, KPA22872 dhe KPA22877) të datës 14 dhjetor 2012, pas seancës gjyqësore të mbajtur më 12 Gusht 2015, mori këtë:

AKTGJYKIM

1. Ankesat e paraqitura nga B. V., të regjistruara me numrat GSK-KPA-A-256/2013, GSK-KPA-A-257/2013, GSK-KPA-A-258/2013 dhe GSK-KPA-A-261/2013, bashkohen në një lëndë të vetme me numrin GSK-KPA-A-256/2013.
2. Hidhen poshtë ankesat e paraqitura nga B. V. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/180/2012 (lëndët e regjistruara në AKP me numrat KPA22870, KPA22871, KPA22872 dhe KPA22877) të datës 14 dhjetor 2012 si të pasafatshme.

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike

1. Më 5 prill 2007, B. V., (në tekstin e mëtejshëm: paraqitësi i kërkesës) ka paraqitur katër kërkesa individuale në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), ku kërkon të drejtën e ri-posedimit dhe kompensim për dëmtimin fizik ose për humbjen e shfrytëzimit mbi pronat e kërkuara.
2. Në këto kërkesa ai kishte theksuar se pronat e kërkuara ishin humbur për shkak të rrethanave që kanë të bëjnë me konfliktin e armatosur që ka ndodhur në Kosovë në vitet 1998/99, ku përmendet data 17 qershor 1999 si data e humbjes.
3. Për të mbështetur kërkesat e tij ai kishte dorëzuar në AKP dokumentet vijuese:
 - Fletën poseduese nr. 772 të lëshuar Organi paralel, Qendra për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë e Komunës së Klinës, të datës 3 prill 2002, që tregon se pronat e kërkuara ishin në posedim të B. V.
 - Autorizimin e datës 14 maj 2012 që tregon se B.V. e kishte autorizuar R.D. për të vepruar në emër të tij para AKP-së.
 - Dokumente tjera (Kontrata të Blerjes) të cilat nuk kanë të bëjnë me pronat e kërkuara.
4. Sipas Fletës Poseduese nr.772 të Organit paralel, Qendrës për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë të Komunës së Klinës, të datës 3 prill 2002, ngastrat kadastrale të kërkuara nga paraqitësi i kërkesës e që ndodhen në zonën kadastrale të Komunës së Klinës, janë të regjistruara në emrin e tij si më poshtë:

Numri i ankesës dhe numri i	Të dhënat lidhur me ngastrën e kërkuar
-----------------------------	--

lëndës së AKP-së	
GSK-KPA-A-256/13 (KPA22870)	Ngastra nr.434, në vendin e quajtur "Sello", vresht e klasit të dytë me sipërfaqe prej 0.02.07 ha
GSK-KPA-A- 257/13 (KPA22871)	Ngastra nr. 435/1, në vendin e quajtur "Sello", mal i klasit të katërt me sipërfaqe prej 0.07.22 ha
GSK-KPA-A-258/13 (KPA22872)	Ngastra nr. 435/2, në vendin e quajtur "Sello", arë e klasit të tretë me sipërfaqe prej 00.02.67 ha
GSK-KPA-A-261/13 (KPA22877)	Ngastra nr. 435/2, në vendin e quajtur "Sello", arë e klasit të tretë, me sipërfaqe prej 0.01.29 ha

5. Gjatë identifikimi të pronave të kërkuara (më 8 maj 2012) është gjetur se ato janë të uzurpuara nga personi i quajtur A. K. i cili kishte ndërtuar objekte të reja komerciale.
6. Sipas raporteve të verifikimit të datës 16 mars 2009 dhe 24 prill 2009, Sekretaria Ekzekutive e AKP-së, ex officio ka siguruar Certifikatën mbi të Drejtat e Pronës së Paluajtshme UL-71006024-00978, të lëshuar nga Zyra Komunale Kadastrale e Klinës më 24 shtator 2009, dhe pronat e kërkuara janë në emër të K. K.. Ndryshimet ishin bërë në vitin 2006 bazuar në Kontratën e Blerjes të legalizuar pranë Gjykatës Komunale të Klinës (Vr.Nr.980/2005) më 21 qershor 2005. Kontrata e Blerjes ishte lidhur në mes të B. V. në cilësinë e shitësit, i përfaqësuar nga R. R. (përmes Autorizimit Vr. Nr. 687/03 të datës 17 shkurt 2003, të vërtetuar në Gjykatën Komunale të Krlevës/Serbi) dhe K. K. si blerës i pronave të kërkuara. Gjithashtu, Ministria e Drejtësisë e Republikës së Serbisë përmes letrës zyrtare VIII. CY. 876/04 të datës 15 tetor 2004 ka vërtetuar vlefshmërinë e Autorizimit Vr.Nr.687/03 të datës 17 shkurt 2003.
7. Gjithashtu, Sekretaria Ekzekutive e AKP-së ka gjetur Vendimin e Gjykatës Ac. Nr. 195/05 të lëshuar nga Gjykata e Qarkut e Pejës më 1 qershor 2005 me të cilën Gjykata e Qarkut e Pejës ka prishur vendimin e Gjykatës Komunale të Klinës C.nr.243/02 të datës 9 prill 2003 dhe ka dërguar lëndën për rigjykim në të njëjtën gjykatë.
Me vendimin C.nr.243/02 të datës 9 prill 2003, Gjykata Komunale e Klinës kishte urdhëruar masat e përkohshme kundër B. V. (pala përgjegjëse në kërkesë në procedurën gjyqësore) të cilit i ishte ndaluar të shiste pronat e kërkuara deri në përfundimin e procedurave gjyqësore apo deri në marrjen e ndonjë vendimi tjetër. Paraqitësi i kërkesës në këtë procedurë gjyqësore ishte pala e tretë (D.G.).

8. Sekretaria Ekzekutive e AKP-së ka kontaktuar përfaqësuesin e autorizuar të paraqitësit të kërkesës më 12 mars 2008, më 29 maj 2009 dhe më 2 nëntor 2009 për ta informuar atë se pronat ishin regjistruar në emër të K. K. Përfaqësuesi i autorizuar i paraqitësit të kërkesës kishte thënë se paraqitësi i kërkesës nuk ka shitur pronat e kërkuara dhe se të gjitha dokumentet ishin falsifikuar nga personi i cili pretendon se ka blerë pronat.
9. Më 14 dhjetor 2014 Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës ka hedhur poshtë kërkesat në vendimin e vërtetuar KPCC/D/A/180/2012. Në paragrafin 27 dhe 77 të vendimit KPCC/D/A/180/2012, i cili zbatohet posaçërisht ndaj kërkesave nr. KPA22870, KPA22871, KPA22872 dhe KPA22877, theksohet se në të gjitha këto kërkesa provat ishin dorëzuar nga paraqitësi përkatës i kërkesës ose nga pala përgjegjëse në kërkesë dhe ishin verifikuar nga Sekretaria Ekzekutive ose ishin siguruar nga Sekretaria *ex officio*, ku paraqitej se paraqitësi i kërkesës, pala përgjegjëse në kërkesë apo pala e tretë kishin paraqitur para datës 16 tetor 2006 padi në gjykatën kompetente ku kërkohej vërtetimi i të drejtës së tij/saj të pronësisë mbi pronat e kërkuara. Në përputhje me nenin 18 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të miratuar me Ligjin No.06/L-079, juridiksioni i Komisionit përjashtohet nëse procedurat gjyqësore lidhur me ndonjë kërkesë kanë filluar para datës 16 tetor 2006, datë kjo në të cilën ka hyrë në fuqi Rregullorja e UNMIK-ut 2006/50. Rrjedhimisht, të gjitha këto kërkesa duhet të hidhen poshtë.
- Paraqitësi i kërkesës kërkon, përveç pronësisë, kompensim për dëmtimin fizik ose për humbje të shfrytëzimit mbi pronat e kërkuara. Sipas Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, Komisioni nuk ka juridiksion mbi kërkesa të tilla. Rrjedhimisht, këto kërkesa duhet të hidhen poshtë.
10. Më 5 gusht 2013, vendimi i ishte dorëzuar B. V. Ai (në tekstin e mëtejme: pala ankuese) ka paraqitur ankesë kundër vendimit më 5 shtator 2013.
- Gjykata Supreme ka pranuar dosjet e lëndëve më 26 nëntor 2013.
11. K. K. ka pranuar vendimin më 26 prill 2013 në cilësinë e palës përgjegjëse në ankesë dhe ai nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë.

Pretendimet e palës ankuese

12. Pala ankuese thekson se vendimi i KPPK-së mbështetet në shkeljen e së drejtës materiale dhe procedurale dhe gjithashtu në vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.
13. Pala ankuese thekson se arsyeja për refuzimin e kërkesave të tij nuk ishte dhënë në asnjë pjesë të arsyetimit ligjor të vendimit të KPPK-së.

14. Sipas palës ankuese, bazuar në një vendim të tillë për të cilin nuk është dhënë asnjë arsyetim, ai vetëm mund të supozoj se e vetmja arsye ligjore për refuzimin e kërkesave të tij mund të jetë se dikush në mënyrë joligjore ka tjetërsuar pronat dhe se ai nuk ka qenë në dijeni për këtë.
15. Gjithashtu, pala ankuese ka shtuar se më 17 gusht 2010, përmes përfaqësuesit të tij të autorizuar ka kërkuar nga Gjykata Komunale e Klinës për të siguruar një kopje të provave në bazë të së cilave kontrata e pretenduar e blerjes (që tregon se K.K. ka blerë pronat e kërkuara nga ai) me të vërtetë ishte legalizuar. Gjykata Themelore e Pejës, dega në Klinë, deri më sot nuk i është përgjigjur atij dhe kjo shpie në faktin se pala ankuese nuk i ka shitur pronat e kërkuara.
16. Në fund të ankesës pala ankuese thekson se Komisioni ka qenë i obliguar t'i dorëzoj atij kontratat e blerjes me anë të së cilave gjoja janë shitur pronat e kërkuara si dhe t'i pasqyronte këto kontrata në arsyetimin e vendimit të saj, kështu, ai do të shfrytëzonte të gjitha mundësitë për të kundërshtuar shitjen dhe për të ndërmarrë të gjitha veprimet e domosdoshme ligjore për të dëshmuar se kontrata e blerjes faktikisht ishte falsifikuar.
17. Pala ankuese gjithashtu kishte prezantuar:
 - Kërkesën drejtuar Gjykatës Komunale në Klinë, me të cilën pala ankuese kërkon të marr Kontratën e Blerjes e cila gjoja pasqyron se ai ka shitur ngastrën nr. 433/1 të Fletës Poseduese nr. 772.
18. Pala përgjegjëse në ankesë ka pranuar ankesën më 6 dhjetor 2013. Megjithatë, ai nuk është përgjigjur në ankesë.

Arsyetimi ligjor

Bashkimi i ankesave

19. Sipas nenit 13.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, Gjykata Supreme mund të vendos për bashkimin apo shkrirjen e ankesave kur një bashkim apo shkrirje e tillë e kërkesave është vendosur nga Komisioni në përputhje me nenin 11.3 (a) të Ligjit. Ky nen i mundëson Komisionit të marr parasysh bashkimin apo shkrirjen e kërkesave për të shqyrtuar lëndën dhe marrë vendime kur ekzistojnë çështje të përbashkëta ligjore dhe të provave.
20. Dispozitat e Ligjit mbi Procedurën Civile që aplikohen në procedurat para Kolegjit të Apelit të Gjykatës Supreme në përputhje me nenin 12.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, si dhe me dispozitën e nenit 408.1 e lidhur me nenin 193 të Ligjit nr. 03/L006 mbi Procedurën Kontestimore, ofrojnë mundësinë e bashkimit të të gjitha kërkesave përmes një aktvendimi nëse kjo do të siguronte efektivitetin e gjykatës dhe efikasitetin e lëndës.

21. Në tekstin e ankesave të paraqitura nga pala ankuese, Gjykata Supreme thekson se përveç numrit të ndryshëm të lëndës për të cilin është paraqitur ankesa përkatëse, faktet, baza ligjore dhe çështjet e provave janë krejtësisht të njëjta në të katër lëndët. Vetëm ngastrat kadastrale që janë subjekt i së drejtës pronësore e cila pretendohet në secilën kërkesë, janë të ndryshme. Ankesat mbështeten në deklaratën e njëjtë shpjeguese dhe në dokumentacionin e njëjtë. Gjithashtu, arsyetimi ligjor i KKPK-së për kërkesat është i njëjti.
22. Ankesat e regjistruara me numrat GSK-KPA-A-256/13 deri GSK-KPA-A-257/13, GSK-KPA-A-258/13 dhe GSK-KPA-A-261/13 bashkohen në një lëndë të vetme me numrin GSK-KPA-A-254/13.

Pranueshmëria e ankesës

23. Ankesa është e pasafatshme.
24. Neni 12.1 i Ligjit nr. 03/L-079 parasheh me sa vijon: *“Brenda tridhjetë (30) ditëve nga njoftimi i palëve nga Agjencia Kosovare e Pronës lidhur me vendimin e Komisionit për kërkesën, pala mund të paraqes ankesë përmes Sekretarisë Ekzekutive të Agjencisë Kosovare të Pronës në Gjykatën Supreme të Kosovës kundër një vendimi të tillë”*.
25. Palës ankuese i është dorëzuar vendimi ditën e Hënë , më 5 gusht 2013. Afati kohor fillon nga dita e Martë, më 6 gusht 2013. Prandaj, afati kohor ka përfunduar më 4 shtator 2013. Megjithatë, pala ankuese ka paraqitur ankesën e tij ditën e Enjte, më 5 shtator 2013. Kjo është jashtë afatit kohor.
26. Prandaj, ankesa është dashur të hedhet poshtë si e papranueshme për shkak të arsyeve procedurale (neni 13.3 nën-paragrafi (b) i rregullores së UNMIKUT 2006/50 i ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079) po ashtu në bazë të nenit 195.1 (a) dhe nenit 196 të LPK-së.

Këshillë ligjore

27. Sipas nenit 13.6 të Ligjit 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit

Elka Ermenkova, Gjyqtar i EULEX-it

Rolandus Bruin, Gjyqtar i EULEX-it

Urs Nufer, Referent i EULEX-it